

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	01/ 2025
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	19.02.2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Haki Hoxha - përfaqësues i Komunitetit Islam
Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Enver Shabani - Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
Bashkim Gashi - përfaqësues e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për Barazi Gjinore
Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së
Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-ve
Refki Zogaj - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit
Eurolinda Zenelaj - përfaqësuese e Mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së
Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve
Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve
Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Nënkyetarja e Komunës e cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i planit operativ për siguri;**
- 4. Informatë dhe diskutim për projektet e infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve;**
- 5. Ligjërata për parandalimin e përdorimit të duhanit dhe dukurive negative në shkollat e mesme;**

Nënkyetarja - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkyetarja - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës;

Nënkyetarja - ia jep fjalën komandantit të policisë.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit. Situata e sigurisë në komunën e Suharekës është e qetë dhe stabile. Bazuar në raportin vjetor të vitit 2024 numri i vjedhjeve ka qenë i barabartë ku 78 raste kanë qenë në vitin 2023 dhe 78 raste në vitin 2024. Vjedhje në tentativë 10 raste vitin 2023- 3 raste në vitin 2024; vjedhje të rënda (të shtëpive) 66 raste në vitin 2023- 55 raste viti 2024. Sa i përket janarit, në vitin 2024 -5 raste kurse në vitin 2025 -3 raste; vjedhje në tentativë asnjë rast kurse vjedhje të rënda në vitin 2024-5 raste kurse në vitin 2025-3 raste; zbulueshmëria e rasteve 81 % në vitin 2024 sipas raportit vjetor kurse në muajin shkurt kemi rritje të vjedhjeve; zbulueshmëria e rasteve 80.05%. Sfidë e policisë së Kosovës është që të kemi ndriçim sepse mungon ndriçimi në disa zona ku po ndodhin vjedhjet pastaj kemi pas probleme me kamera në qytet për shkak të ndërtimeve e që na kanë shkaktuar probleme në zbulueshmërinë e rasteve sepse numri më i madh i vjedhjeve është në qytet. Ne ju kemi drejtuar me një shkresë Kuvendit Komunal dhe shpresoj Komuna do ti rregulloj, gjithashtu ka premtu që edhe në Mushtisht do të vnerdosen kamerat.

Nënkyetarja - ne si komunë vazhdimisht kemi punu në ndriçimin e të gjitha rrugëve e rrugicave ku kemi projekte të veqanta dhe mendoj që është bërë punë e jashtëzakonshme me ndriçim por do të punojmë tutje që të mos ngel asnjë rrugë pa ndriçim. Po ashtu vendosja e kamerave në Mushtisht është në procedurë dhe po ashtu edhe në udhëkryqet ku ka qenë kërkesë e policisë.

Avni Bytyqi - i falënderojmë për angazhimin dhe punën që bëjnë por me siguri që e bëjnë edhe me ndonjë bashkëpunim me qytetarët dhe akterët tjerë për çështjen e zbulueshmërisë dhe veprave penale.

Rekomandim: Të vazhdohet bashkëpunimi mes policisë, komunës dhe qytetarëve me qëllim të zbulimit të veprave nga keqbërësit dhe komuna ta merr për obligim që kur do herë që paraqitet nevoja dhe kërkesa nga policia për rregullimin e ndriçimeve, ti realizon projektet që kërkohen nga policia.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i planit operativ për siguri;

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit. Ne si DKA që nga viti 2022 në koordinim me policinë e Kosovës në Suharekë kemi bërë punë shumë të rëndësishme në çështjen e sigurisë ku në secilën shkollë kemi formu nga një komision lokal të shkollës për siguri në shkolla që përbëhen prej 5 anëtarëve. Deri më tani janë menaxhu mirë dhe nuk kemi ndonjë incident që vlen për ta veçu përpos një rasti që ka qenë para një muaji në shkollën e Shirokës, rasti me qenin dhe sigurisht jeni të informuar dhe e keni pa. Ka qenë mjaft shqetësuese forma se si është trajtu situata por fatmirësisht nxënësi i lënduar e ka tejkalu çështjen shëndetësore, është shumë më mirë dhe pritet me vazhdu mësimin. Ne si DKA bashkë me policinë e kemi menaxhu situatën, e kemi vizitu familjen, kemi vizitu fëmijën në spital, kemi bërë një aksion bashkë me policinë në rehabilitim të situates me një aktivitet motivues.

Habibe Bytyqi - për rastin në Shirokë që potencoi drejtori, a ka shkolla në Shirokë psikolog ? Nëse ka psikolog, sa është punu me fëmijën që ka pësuar por edhe me fëmijët e tjerë ? Sepse vërtetë ajo që ka ndodh ka qenë traumatike për nxënësit dhe mendoj që duhet të ndërhyjë edhe psikologu.

Remzi Bajselmani - njëra nga pikat kryesore ka qenë përmirësimi i gjendjes traumatike të fëmijëve. Shkolla përkatëse e ka psikologun, një ndër më të mirat në Komunë. Është edhe anëtare e ekipës për vlerësim dhe intezivisht ka punu me fëmijun e kafshuar. E ka vizitu edhe në spital mandej ka marrë rekomandime nga ne që të punojë me nxënësit që kanë nevojë dhe me prindërit. Situata është rehabilitu.

Nënkryetarja - rasti i Shirokës ka qenë shqetësues për gjithë opinionin dhe me të dëgjuar Kryetari sëbashku me Drejtorin e Arsimit kanë dal menjëherë në vendin e ngjarjes. Një meritë shumë të madhe dhe falënderim ia bëj komandantit të policisë që menjëherë patrulla e policisë ka shku në vendngjarje dhe ka marr masa dhe gjithëashtu falemnderojmë Drejtorinë e Shëndetësisë dhe urgjencën.

Afrim Sylaj - Sa i përket sigurisë nëpër shkolla, ne e kemi planin operativ sigurisë nëpër shkolla dhe raportojmë në baza javore. Të gjitha takimet që zhvillojmë brenda vitit me drejtor, gjithnjë për me ofru një siguri sa më të mirë afër shkollave. Bashkëpunimi ynë lidhet edhe me ofrimin e sigurisë dhe në ligjerimin në shumë shkolla. Sa i përket rastit në Shirokë, me keqardhje e them që ka ndodh një rast i rrallë ku ne është dashtë të ndërhyjmë mirëpo ne e dime problemin me qentë endacak ku kemi pas 18 raste gjatë vitit që janë kafshu njerëz ku shumica e tyre janë nxënës por nuk kanë qen me përmasa të mëdhaja. Pra kemi bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha institucionet shkollore dhe ky bashkëpunim duhet të vazhdohet.

Avni Bytyqi - rekomandimet që kanë dal nga ky këshill, sidomos për çështje të sigurisë kanë qenë shumë efektive dhe policia në këtë rast janë treguar shumë vigjilent në këto raste.

Rekomandim: Policia me mundësitë e veta dhe kapacitetet e veta të burimeve njerëzore në çdo kohë t'ju përgjigjen ftesave të DKA-së dhe drejtorëve të shkollave që të jenë prezent edhe në stacionin e autobusëve dhe në mes-ndërrimin e shkollave në afërsi të shkollave me uniforma civile me qëllim të sigurisë së përgjithshme për nxënës dhe qytetarë.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 4. Informatë dhe diskutim për projektet e infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve;

Nënkryetarja - ne jemi të gjithë dëshmitarë të faktit që gjatë punimeve në rrugë ku këto tri vite kemi pas punimet në shesh, pastaj vazhdimin e punimeve për pjesën tjetër të sheshit ku qytetarët tonë janë ballafaqu me problematika të lvizjes së lirë por ne si komunë jemi munduar të paktën përmes shenjave, shiritave, t'ua lehtësojmë dhe tani gjendja është më e mirë, lëvizja është më e lirë, çoftë edhe për automjete.

Habibe Bytyqi - si qytetarë dhe unë personalisht kemi mirëkuptu sepse kur punohet edhe pengohet liria e lëvizjes por hallin më të madh e kam tash me rrugën "Skënderbeu". Nuk e di a është përfunduar gjithçka por ashtu duket. Siq e dini ajo rrugë në njërin pjesë dikur ka pas trotuar dhe tani nuk ka fare. Hyrje-daljet që janë kriju nuk a di a janë me standarte apo nuk janë por po e shoh që vazhdimisht ka probleme me veturat te ato ndërlihdhet që janë bë me rrugës dhe për mua është një shqetësim i madh dhe sidomos i trotuarit sepse aty kalojnë nxënës, qytetarët dhe është rrezik. Gjithëashtu problematikë është rruga prej rrethit që shkon teposht ku unë kaloj. Ka dy muaj që është një shakt i hapur e që është shumë i thellë dhe kapaku i shaktit është afër dhe nuk e di pse kurrë nuk mbulohet sepse është rrezik për fëmijët dhe të tjerët.

Nënkryetarja - shqetësimi yt është me vend por sigurisht këto i kanë parapa personat profesional dhe rruga ende nuk ka përfunduar. Unë nuk mund të jap përgjigje por shqetësimin tënd do ta delegoj te Drejtoria përkatëse.

Afrim Sylaj - kemi diskutu lidhur me rrugën "Skënderbeu" dhe na kanë thënë që ende nuk kanë përfunduar punimet dhe ne kemi kërku me vendos shenja për shkak se po ndodhin aksidente. Kemi shqetësime nga qytetarët për shkak të vozitjes së shpejtë aty. Ne disa herë kemi dal me radar por ne duhet të përcaktohem me shenja të komunikacionit dhe nuk mund ti denojmë. Ne si polici kemi kërku me bo disa ndryshime që mos me u kriju shumë hyrje-dalje sepse janë dy rrethe dhe nuk janë në largësi. Sa i përket informatës kemi probleme te restaurant "Suare" ku ajo pjesë është shesh dhe shfrytëzohet për parkingun e veturave dhe nuk ka trotuar fare, andaj duhet të lirohet ajo pjesë dhe të vendosen shenja për ndalim parkingu sepse ankesat e qytetarëve janë të shumta dhe të lirohen vendet publike sa më shumë.

Avni Bytyqi - edhe unë e kam shqetësim çështjen e rrugës "Skënderbeu" dhe e di që nuk është e shënjestuar dhe ndoshta është mirë që policia me dal dhe së paku me iu tërheq vërejtjen. Kam pa x raste që edhe nëpër ato ishujt që përmendet, i lënë veturat dhe e pengojnë komunikacionin.

Rekomandim: Komuna ta merr obligim që të bën shenjëzimin e të gjitha rrugëve nëpër qytet, me thelb të veçantë sheshin dhe rrugën "Skënderbeu".

Rekomandim: Policia pas vendosjes së shenjave nga komuna, të zbaton ligjin ashtu siq kërkohet dhe ti liroj trotualet publike me qëllim të lëvizjes së lirë të qytetarëve.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Pika 5. Ligjerata për parandalimin e përdorimit të duhanit dhe dukurive negative në shkollat e mesme;

Remzi Bajselmani - komuna e Suharekës qëndron mjaft mirë në punësimin e psikologëve nëpër shkollat dhe kemi 12 psikolog që janë të përfshirë të gjitha shkollat e komunës sonë. Kjo temë është njëra prej temave më të rëndësishme që ndikon në edukimin e brezit të ri dhe jo vetëm për duhanin por edhe për substancat tjera që flitet se përdoren. Sipas planit të punës javën që vjen ne do të takojmë të gjithë psikologët e shkollave, do të shohim planin e punës së tyre dhe në koordinim me planin do të ftojme një mjek përkatës nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe nëse e shohim të arsyeshme bashk me policin me sjell një ekspert nga policia për ta trajtuar ndonjë rast dhe në muajin mars të mbahen ligjerata në tri shkollat të mesme dhe nëse është e nevojshme edhe në shkollat e mesme të ulëta, klasat e nënta.

Nënkryetarja - më herët edhe OJQ-ve iu ka dhënë hapësira për me mbajt ligjerata të tilla.

Remzi Bajselmani - përmes Drejtorisë së Kulturës kanë marrë subvencione disa organizata të ndryshme të cilave ne iu kemi dhënë pëlqim dhe kanë dhënë ligjerata.

Avni Bytyqi - ideja e Drejtorit mua më pëlqen sepse janë njerëz profesional dhe brenda për brenda institucionit dhe nuk ka kosto financiare fare dhe pse jo edhe policinë dhe FSK-në që kanë njerëz profesionist dhe ekspert të lamive të ndryshme të dukurive negative dhe çështjes së përdorimit të duhanit, t'ju bëjmë një ftesë dhe në bashkëpunim me këta akter të mbajmë një ligjeratë.

Afrim Sylaj - ligjerata të jetë për përdorimin e duhanit dhe alkoolit sepse shumë adoleshent kanë kureshtjen vazhdimisht me përdor alkool.

Avni Bytyqi - në kuadër të dukurive negative hyn edhe këto.

Eurolinda Zenelaj - pajtohem plotësisht me ato që tha drejtori. Unë kur kam qenë në shkollë fillore kemi pas raste kur kemi mbajtur ligjeratë por nuk kanë qenë shumë efektive sepse në moshën 13-14 vjeqare nuk mund ti perceptosh disa gjëra si i sheh tash si më të rritur që jemi. Do të ishte mirë me u përfshi edhe prindërit pak më shumë sepse ka prind që e nis fëmijën e vet në shkollë pa ia kontrollu qantën asnjëherë. Po ashtu ndikon edhe pjesa financiare sepse nëse ka para një fëmijë shumë, ai e ka luksin me ble alkool, cigare dhe gjëra tjera dhe ka fëmijë që nuk kanë por shkojnë mbrapa tyre. Ndoshta ligjerata është mirë të mbahet së pari me prind e pastaj me fëmijë. Njoh raste konkrete ku një fëmijë që nuk ka konsumu duhan, është largu prej rrethit shoqëror dhe u bullizua dhe e kanë vendos para aktit të kryer dhe asnjë reagim prej mësimdhënëses, as pse nuk flisni me shokun e klasës dhe as nuk është njoftu familja.

Nënkryetarija - edhe unë vet kam qenë mësimdhënëse dhe patjetër duhet ky trekëndëshi mësimdhënëse-prind-nxënës. Prindi gjithësesi duhet njoftuar për çdo gabim të vogël

Rekomandim: sa më parë që është e mundur Drejtoria ta realizon programin që e ka parapa dhe njëkohësisht ti bëjë kërkesë FSK-së që ta kenë një përfaqësues të vet për mbajtjen e ligjeratave.

Habibe Bytyqi - a mund të përfshihet edhe njëri prej aktiviteteve që e kanë planifiku këta dhe të jetë propozimi i koleges që të përfshihen edhe prindërit, ose të jenë prezent ose të jetë takim i veçantë me prindërit?

Avni Bytyqi - prezenca e prindërve është e mirëseardhur.

Nënkryetarija - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi.

Takimi përfundoi: 10:55

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj